



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.157/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së njoftimit për tubim publik në hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohen si të bazuara ankesat e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2.500,00 (dymijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar gjashtë ankesa: A.nr. 157/2017, A.nr. 158/2017, A.nr. 159/2017, A.nr. 160/2017, A.nr.161/2017 dhe A.nr. 162/2017 nga subjekti politik LVV, me të cilat pretendon se aktivistët e tyre kanë vërejtur, se në rrugët “Vëllezërit Fazliu”, “Fahri Fazliu”, “Tutini”, “Asllan Pireva”, “Mic Sokoli” dhe “Nexhmi Llumnica” në vende publike ishin vendosur njoftime për mbajtjen e tubimit të subjektit politik LDK. Me këtë rast parashtresë i ankesave thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073, nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së, duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur njoftime për tubime në hapësirë publike.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.157/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të gjitha ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Në përgjigje në ankesat e datës 11.10.2017, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) thekson se ankesat e subjektit politik LVV janë të pa bazuara, për faktin se nuk mund të pretendohet se ka ndodhur shkelja e rregullave zgjedhore, pasi që fjala është për njoftim mbi tubimin elektorale, që ka karakter të një njoftimi të përkohshëm mbi zhvillimin e një ngjarje. Ndër të tjera subjekti politik LDK, thekson se tubimi do të mbahej në lagjet e caktuara të Prishtinës dhe se duhej të njoftoheshin vetëm qytetarët e atyre lagjeve, por që për njoftimet e tyre nuk

ka asnjë hapësirë ku do të vendoseshin këto njoftime me karakter të përkohshëm. Më tej subjekti politik LDK thekson se subjekti politik LVV ka për qëllim të dëmtoj LDK, për faktin se për secilin njoftim të fotografuar (njoftimi i njëjtë për ngjarjen e njëjtë, sepse disa vërehen nga përmbajtja e disa nga formati i njëjtë) është dorëzuar nga një ankesë e veçantë., dhe se pas marrjes së ankesave nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljeve sipas ankesave. Përgjigjes së ankesave si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur fotografi nga vendi ku janë larguar njoftimet.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara.

Nga fotografit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se njoftimet për tubime të subjektit politik LDK, janë vendosur në vende publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që njoftimet për tubimet e subjektit politik LDK, janë vendosur në vende publike. Të cilat shkelje i ka evituar edhe vetë subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 11.10.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti njoftimet për tubim të fushatës zgjedhore nga subjekti politik i LDK-së, janë vendosur në vende publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr njoftimet nga vendi i palejuar, të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 157/2017 më datën 12.10.2017



Përyesuese e Panelit
Gjytene Sylejmani

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 par.4 të LZP-së.